

V E N D I M

Nr.24, datë 21.1.1999

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.446,
DATË 9.7.1998, “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË
PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE, QË
VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË” NDRYSHUAR ME VENDIMIN E
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.684, DATË 28.10.1998**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 2, të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.446, datë 9.7.1998, në kapitullin II, shkronja “c”, në pikën 1, shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Në shoqëritë, ku paketa shtetërore është nën 50 për qind e aksioneve të shoqërisë, pasi të jetë zbritur përqindja e aksioneve për ish-pronarët e truallit dhe për punonjësit e shoqërisë, pjesa e mbetur e paketës së aksioneve u ofrohet ortakëve të shoqërisë, pa ankand.

Në rast refuzimi, tërësor ose pjesor, të paketës së ofruar të aksioneve, procedohet me privatizimin e tyre me ankand, në këmbim të bonove dhe të lekëve të privatizimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI
Pandeli Majko**